

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

Blerje produkte ushqimore per institucionet e varsise,Bashkia Puke

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Produkte Ushqimore te ndryshme 15800000-6**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

2,617,455 (Dy milion e gjashtëqinde e shtatembedhjetemije e katerqinde e pesedhete e pese )  
leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Bashkia Puke ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës4;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

## 2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

## 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. a. *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë “Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të lëshuara nga administrata tatimore për vitet 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet”. Në plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë: Vertetim nga Dega e Tatim-Taksave për xhiron e realizuar gjatë viteve të sipërpërmendura.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke parë vlerën e fondit limit të përcaktuar e cila nuk është e lartë dhe vlera 40% e fondit limit për xhiro vjetore nuk cenon pjesëmarrjen e op.ekonomik as atyre që janë biznes i vogël duke garantuar konkurrencë të hapur dhe mos cenimin e asnjë op.ekonomik.

---

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë numrin e operatoreve ekonomik që ofrojnë këto lloje furnizimesh në tregun shqiptar, sasinë dhe cilësinë e mallit objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë dokumenta se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Kerkohet per 3 vitet e fundit duke marre ne konsiderate vleren e objektit dhe per te qen sa me konkruuese per te gjithë op.ekonomin te vegjel apo te medhenj.

2.2.2.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021,2022 dhe 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të **kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”**, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar).

Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Kerkohe për 3 vitet e fundit duke marrë në konsideratë vlerën e objektit dhe për të qen sa më konkurruese për të gjithë op.ekonomik të vegjël apo të mëdhenj.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1.Furnizime të ngjashme me një vlerë **me një vlerë jo më të vogël** se 20 % të **te vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**. Dëshmitë për furnizimin e mallrave duhet të jepen përmes vërtetimeve të marrësit të mallit për përmbushje me sukses të kontratës të shoqëruar me kontratën e lidhur me Autoritetin Kontraktor dhe Operatorin Ekonomik

*- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara”.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke parë vlerën e fondit limit për këto objekt mendojmë që marzhi i përcaktuar 20 % i cili është dhe maksimali për këto model procedure vendoset për të demonstruar që op.ekonomik kanë furnizime të ngjashme të kësaj natyre dhe jap garanci për realizimin e kontratës sipas specifikimeve dhe afatit të realizimit. Vlera e ngjashme nuk cenon asnjë op.ekonomik pasi është e përballueshme dhe në proporcion të plotë me objektin

**2.3.2.** License të leshuar nga QKL me kod II.1.B . (Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore për njëzë). Të posedoj op.ekonomik ose kontrata bashkëpunimi me një op.ekonomik që e posedon këto license.

**Kriteri është vendosur për të garantuar që produktet që ofrohen të jenë nga subjekt i licensuar sipas legjislacionit shqiptar dhe që garanton cilësi dhe siguri për konsumatorin. Për të mos qenë kriter diskriminues dhe për të garantuar konkurrencë të lirë dhe të madhe është vendosur dhe opsioni I bashkëpunimit me sipas legjislacionit në fuqi me op.ekonomik të licensuar bazuar në pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë**

**23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021  
“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”**

**2.3.3.**Dokument qe verteton se ka ne pronesi,me qera ose me kontrate bashkepunimi ( kontrate noteriale) njesi te tregtimit ushqimore , shoqeruar me leje higjeno-sanitare leshuar nga autoritetet perkatese e vlefshme per te gjithë periudhen e zbatimit te kontrates.

**Kriteri eshte vendosur per te garantuar qe produktet qe ofrohen te jen nga subjekt i licensuar sipas legjislacionit shqiptar dhe qe garanton furnizimin sipas sasive te percaktuara dhe afateve perkatese. bazuar ne pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”**

**2.3.4.**Dokument qe verteton se ka ne pronesi,me qera ose me kontrate bashkepunimi ( kontrate noteriale) njesi te tregtimit te mishit, shoqeruar me leje higjeno-sanitare leshuar nga autoritetet perkatese e vlefshme per te gjithë periudhen e zbatimit te kontrates .

**Kriteri eshte vendosur per te garantuar qe produktet qe ofrohen te jen nga subjekt i licensuar sipas legjislacionit shqiptar dhe qe garanton furnizimin sipas sasive te percaktuara dhe afateve perkatese. bazuar ne pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”**

**2.3.5.**Ofertuesi duhet te kete ne pronesi me qera ose ne perdorim kundrejt kontrates perkatese te noterizuar, mjete transporti te vlefshme per te gjithë periudhen e zbatimit te kontrates si me poshte:

- 1(nje) automjet te pershtatshem (frigorifer) per transportimin e mallrave ne perputhje me specifikimet teknike.

Per automjetet te paraqiten certifikata e pronesise,kontratat e shit-blerjes,kontratat e dhurimit ose te qerese sipas rastit,si dhe dokumentacionin perkates siguracionet,lejet e qarkullimit dhe aktin e kolaudimit te automjeteve ne dispozicion dhe leja higjeno-sanitare perkatese.

***Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

**Kriteri eshte vendosur per te garantuar qe produktet qe ofrohen te jen nga subjekt i licensuar sipas legjislacionit shqiptar dhe qe garanton furnizimin sipas sasive te**

**percaktuara dhe afateve perkatese dhe sipas kushteve higjeno sanitare dhe ruajtjes se produktet sipas kushteve dhe norvave.**

**2.3.6.** Dokument me anen e te cilit vertetohet se subjekti juaj eshte i regjistruar prane Autoritetit Kombetar te Ushqimit (AKU)

**Kriteri eshte vendosur per te garantuar qe produktet qe ofrohen te jen nga subjekt i licensuar sipas legjislacionit shqiptar dhe qe garanton furnizimin me cilesi dhe siguri dhe I kontrulluar nga organet perkatese ligjore. bazuar ne pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”**

2.3.7.License e leshuar nga QKL II.1.A.1 - “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, të leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Ta pasedoj op.ekonomik ose kontrata bashkepunimi me nje op.ekonomik qe e posedon kete license.

**Kriteri eshte vendosur per te garantuar qe produktet qe ofrohen te jen nga subjekt i licensuar sipas legjislacionit shqiptar dhe qe garanton cilesi dhe siguri per konsumatorin.Per te mos qen kriter diskriminues dhe per te garantuar konkurrence te lire dhe te madhe eshte vendosur dhe opsioni I bashkepunimin me sipas legjislacionit ne fuqi me op.ekonomik te licensuar. bazuar ne pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”**

2.3.8.Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standardet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë, ai duhet të paraqesë vetdeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli I fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. Ndërsa, operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës ka detyrimin të paraqesë dokumentacion provues, ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtronaktivitet konform kërkesave ligjore.

**Bazuar ne pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Kriteri eshte vendosur per te garantuar qe produktet qe ofrohen te jen nga subjekt i licensuar sipas legjislacionit shqiptar dhe qe garanton cilesi dhe siguri per konsumatorin.**

**2.3.9.**Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2023 sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

**Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

### **Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit:**

Bazuar në nenin 76 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në përlllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, Autoriteti Kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- a) çmimet e botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

Specialisti i ngarkuar, duke marrë në konsideratë rastin në fjalë, natyrën/specifikat e këtij prokurimi, legjislacionin dhe rregullat e tregut për këtë shërbim, ka organizuar punën dhe ka

ndërmarrë hapa konkret për mënyrën e përlllogaritjes të vlerës së prokurimit bazuar në nenin 76 të VKM 285 date 19.05.2021.

*Sa i përket respektimit të pikës “a”, Specialisti i ngarkuar ka kontrolluar në faqen zyrtare Institutit të Statistikave (INSTAT), për të marrë informacion mbi çmimet për objekt” duke specifikuar të dhënat e nevojshme për identifikimin e këtyre artikujve që Autoriteti Kontraktor “DPPGJ” kërkon. INSTAT nuk disponon çmime të botuara për kete lloj procedure.*

- *Sa i përket respektimit të pikës “c”, Specialisti i ngarkuar nuk mund të marrë si shembull çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara pasi nuk është realizuar ndonjëherë një shërbim apo blerje e tillë.*

*Specialisti i ngarkuar, duke marrë në konsideratë rastin në fjalë, natyrën/specifikat e këtij prokurimi, legjislacionin dhe rregullat e tregut për këtë blerje malli, ka organizuar punën dhe ka ndërmarrë hapa konkret për secilën nga alternativat e përcaktuara në nenin 76 të VKM 285/2021 për llogaritjen e vlerës limit të kontratës ( fondit limit), me qëllimin që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë. Lidhur me këtë proces, Specialisti i ngarkuar ka argumentuar dhe dokumentuar referuar materialeve bashkelidhur, konkretisht:*

- ❖ *Sa i përket respektimit të pikës “b”, Specialisti i ngarkuar, bazuar në rregullat e tregut, ka kryer studimin e tregut nëpërmjet marrjes së ofertave, për të njohur për aq sa është e mundur, nivelin e tregut aktual. Operatorët Ekonomik të përzgjedhur në mënyrë rastësore për marrjen e ofertave për testimin e tregut, janë subjekte tregtare të licensuara dhe të regjistruar pranë QKB dhe referuar objektit të veprimtarisë së tyre të publikuara në faqet on-line respektive, por edhe sipas Ekstraktit të Regjistrimit publikuar në faqen zyrtare on-line të QKB, rezultojnë se kanë në objektin e veprimtarisë së tyre, fushen objekt prokurimi.*

*Specialisti i ngarkuar ka kontaktuar me këto subjekte që operojne në treg, për marrjen e ofertave. Format e komunikimit me subjektet e tregut kanë qenë ato të parashikuara në ligj dhe konkretisht me nëpërmjet postës elektronike, në varësi të rrethanave dhe mundesive reale të komunikimit. Subjektet që veprojnë në këtë sektore, janë njohur me sasitë dhe specifikimet teknike të kërkesave tona, për sa i përket, dhe identifikimit të artikujve në treg, në mënyrë që këta të fundit të kishin mundësi të analizonin dhe të jepnin ofertat e tyre të përafërta, Specialisti i ngarkuar ka marrë në treg 3 (tre) oferta ekonomike.*

### **Argumentimi i specifikimeve teknike:**

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Në specifikimet teknike që janë hedhur në dokumentet teknike të tenderit nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose



shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialisti i shërbimeve hartues dhe i preventivit pjese e njësisë së prokurimit dhe kriteret teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.i ndryshuar

**Njesia Prokurimit**